



Pranuar / Dorezuar Prilbena/Prodato Received/Delivery	27 - 12 - 2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMETICK	7683/2023		1/9



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1402/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.1402/2023 të datës 10.11.2023, të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokate

kundër organit të punësimit Komuna e Gjilanit, në çështjen juridike "Ndërrprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.1402/2023 të datës 10.11.2023, të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja, përmes përfaqësueses së autorizuar me datë 07.11.2023 përmes poste ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 10.11.2023 me numër protokolli 6960/2023 e regjistruar me numër A.nr.1402/2023, kundër Komunës së Gjilanit lidhur me pretendimin ankimor për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te ankueses tek Komuna e Gjilanit. Ndërsa Këshilli me datë 27.11.2023 ka pranua nga Komuna e Gjilanit, përgjigjen në kërkesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6960/2023 të datës 10.11.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 10.10.2023; Akt emërimit e datës 03.05.2011; Shkresën e datës 15.03.2023; E-mailin e datës 01.03.2023 dërguar nga B.S për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitura; Përgjigjen e datës 24.10.2023; Kërkesën e ankueses së datës 23.08.2023; Kërkesën e datës 31.10.2023; E-mailin e datës 24.01.2023 dërguar nga ankuesja për G.N; Listën e datës 30.01.2023; E-mailin e datës 27.02.2023 dërguar nga B.D për A.D me korrespondencën e bashkangjitur; Listën e pagave për muajt dhjetor 2022-mars 2023; Plane pune i ankueses; Formular i datës 20.10.2023; Formular i datës 09.10.2023; Vendimin e datës 02.10.2023 të Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Ankesave të Komunës së Gjilanit; Zarf postar i datës 07.11.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë, Përgjigje në kërkesë e datës 27.11.2023 me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën drejtuar Drejtorisë së Arsimit-Gjilan e datës 21.03.2023; Konkurs për plotësimin e vendeve të lira të punës; E-mail i dërguar nga B.S drejtuar SH.H e datës 01.03.2023 E-mail i dërguar nga B.A drejtuar A.D e datës 27.02.2023; E-mail i dërguar nga SH.H drejtuar A.D e datës 24.03.2023; Akt emërim më numër 16-20128 të datës 22.07.2011; E-mail i dërguar nga SH.H drejtuar A.D e datës 22.12.2022; E-mail i dërguar nga B.A dërguar A.D e datës 20.02.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 07.04.2023; Përgjigja në ankesë e datës 26.04.2023; Vendimi për emërimin e komisionit të intervistimit dhe përzgjedhjen e kandidatëve me numër 1062 i datës 06.11.2018; Kërkesë e datës 09.11.2018; Njoftim me numër 124265 e datës 19.11.2018; Procesverbal i datës 19.11.2018; Vendim i Drejtorisë së Arsimit me numër prot.133394 e datës 19.12.2018; E-mail i dërguar nga N.G drejtuar KPMSHCK i datës 10.01.2019; Kontratë pune me numër 610-30222 e datës 14.01.2019; Përshkrim i detyrave të punës; Listë distribuimi me numër 19474 i datës 22.02.2023; Vendim me nr.prot.531/2022 i datës 16.12.2022; Listë distribuimit me numër 26143 i datës 14.03.2023; Vendim me numër prot 237/2023 i datës 03.03.2023; E-mail i dërguar nga B.S drejtuar A.T i datës 14.03.2023; Formular për listë të pagave i datës 01.03.2023; Opinion ligjor me numër 3198 i datës 10.01.2023; Kërkesë për interpretim me numër 20813 i datës 27.02.2023; E-mail i dërguar nga I.K drejtuar B.S e datës 14.03.2023; E-mail i dërguar nga B.S drejtuar B.A e datës 24.04.2023; Pliko e bardhë me numër R2785719.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1402/2023 të datës 10.11.2023, të parashtruar nga ankuesja *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesja në bazë akt emërimit më numër 16-20128 të datës 22.07.2011 është emëruar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Gjilanit me titullin e punës "Psikologe e Shkollave", ndërsa e njëjta pas nënshtrimit të procedurës së rekrutimit të Konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës me numër të referencës RN0003888, përmes Vendimit numër: 133394 të datës 19.12.2018 është zgjedhur "Drejtore" në Institucionin Parashkollor "Dardani" në Komunën e Gjilanit.

Ankuesja, sipas Kontratës së punës për pozitën "Drejtore" i Institucionit Parashkollor kishte mandat 4 vjeçar e i cili do të përfundonte me datën 24.12.2022, ndërsa e njëjta pas nënshtrimit të procedurës së vlerësimit të jashtëm të performancës nga Inspektorati i Arsimit është konstatuar se ankuesja nuk ka pasur kualifikimin adekuat për tu zgjedhur "Drejtore" në institucionin edukativo-arsimor dhe përmes Vendimit me nr.prot.531/2022 të datës 16.12.2022 ka obliguar Komunën e Gjilanit që ankueses t'i ndërpritet kontrata e punës.

Tutje, ankuesja me datën 10.01.2023 ka parashtruar ankesë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit kundër vendimit të Inspektoratit të Arsimit për ndërprerjen e Kontratës së Punës, ndaj të cilës Komisioni "Paneli i Artë" ka marrë Vendimin me nr.prot.237/2023 të datës



03.03.2023 ku ka refuzuar ankesën si të pabazuar. Ankuesja me pas rifillon punën në pozitën "Psikologe e Shkollave" deri në muajin mars kur edhe njoftohet që në listën e pagave është proceduar me ndryshim me arsyetimin se nuk ka ndonjë vendim për ruajtje të vendit të punës për pozitën "Psikologe" nga Drejtoria Komunale e Arsimit, ngase ankuesja iu kishte nënshtruar procedurave të rekrutimit ku edhe ishte përzgjedhur pozitën "Drejtor" i Institucionit Parashkollor "Dardania" në Gjilan ku edhe kishte vazhduar ta ushtronte këtë detyrë deri në nxjerrjen e Vendimit me nr.prot.531/2022 të datës 16.12.2022 nga Inspektorati i Arsimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shkresat e lëndëve që shqyrton në procedurë administrative, ka gjetur se ankuesja po ashtu me datë 20.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me nr.prot.237/2023 të datës 03.03.2023 të Komisionit "Paneli i Artë" të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ku për objekt shqyrtimi në parim ka qenë e njëjta çështje administrative, gjegjësisht mos vazhdimi apo përfundimi i parakohshëm i marrëdhënies së punës, ndërsa Këshilli me datë 02.05.2023 ka nxjerrë Vendimin A.nr.539/2023 përmes të cilit është shpallur jo kompetentë për të shqyrtuar ankesën e ankueses meqenëse është konstatuar se e njëjta nuk e ka statusin e nëpunëses civile duke e bartur lëndën për shqyrtim dhe vendosje te organi kompetentë/Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Komunës së Gjilanit, po ashtu Komisioni për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i Komunës së Gjilanit përmes Vendimit të datës 02.10.2023 e ka udhëzuar ankuesen në kontest punë në gjykatën kompetente sipas juridike, andaj bazuar në rrethanat si me lartë, në mbështetje të dispozitave të nenit 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: "Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, ", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se qëllimi i ankesës A.nr.1402/2023 i datës 10.11.2023, është bërë nga pala e njëjtë me të njëjtin qëllim dhe mbi të njëjtën situatë faktike sikurse në ankesën e vendosur A.nr.539/2023 të datës 20.03.2023, nga rrjedh se janë plotësuar të gjitha parakushtet ligjore, prandaj Kolegji i Këshillit ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1402/2023 të datës 10.11.2023.

Përveç asaj që u konstatua si më lartë, Kolegji i Këshillit thekson faktin se përveç vendimmarrjes se shprehur me datë 20.03.2023 përmes Vendimit me shifër A.nr.539/2023 ku Këshilli ishte shpallur jo kompetentë për shkak se e njëjta nuk e ka statusin e nëpunëses civile, gjithashtu edhe përmes Vendimit A.nr. 611/2023 të datës 18.05.2023 Këshilli kishte përfunduar procedimin administrativ të filluar me ankesën e ankueses të datës 04.04.2023 për arsyet e dhëna sikurse në arsyetimin e këtij vendimi, prandaj për Kolegjin e Këshillit mbetet e paqartë dhe e pakuptueshme rruga e ndjekur juridike e ankueses apo përfaqësueses së saj të autorizuar, ku brenda një vitit pavarësisht shpalljes jo kompetent nga ana e Këshillit, e njëjta vazhdon të parashtronte ankesë në kontinutet edhe për dy herë të tjera radhazi mbi të njëjtën situatë fakte, rrethana dhe bazë të njëjtë juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1402/2023

Flakron Gashi

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësueses së ankueses,
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjilanit dhe
- Arkivot të KPMSHCK- së;

